



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



PLANI I PUNËS

DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

VITI 2021

Janar, 2021

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrje.....	3
Plani i punës.....	4
Vizioni.....	4
Misioni.....	4
Objektivat strategjike.....	5
Orientimi i përgjithshëm.....	7
Buxheti i Drejtorisë për Arsim për vitin 2021	8
Plani i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2021.....	9
Plani i punës për përgaditjen e lokaleve shkollore për vitin shkollor 2021.....	9
Financimi vjetor i investimeve kapitale për vitin 2021.....	12
Plani i punës së procesit edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2021.....	12
Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-së me Kryetarin e Komunës, MASHT-in , drejtorët e drejtorive nga komunat tjera dhe me qytetarët.....	15
Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë: policinë, KFOR-in, OJQ dhe mediat.....	16
Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane.....	16
Buxheti i Arsimit për vitin 2021 sipas kategorive.....	17
Plani i rekrutimit të Personelit Arsimor – viti kalendarik 2021.....	18
Plani i Garave shkollore me nxënës.....	19

Hyrje

Në këtë plan janë të përfshira të gjitha aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Arsimit, për katër nivelet shkollore sipas Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (në vazhdim SNKA) dhe atë si vijon:

- SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII),
- SNKA 2 - Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasat VI-IX),
- SNKA 1 - Arsimi Fillor (Klasat I-V),
- SNKA 0 - Klasat Parafillore (5-6 vjeç)

Ky plan ka për bazë aktivitetet që do të realizohen në të gjitha Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta (Gjimnaze dhe Shkolla Profesionale) në komunën e Deçanit.

Plani i punës përfshinë aktivitetet për përgatitjen e vitit të ri shkollor, aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore, bashkëpunimin e DKA-së me kryetarin e komunës, MASH-in, drejtoritë e tjera komunale, me qytetarët, komunitetin e prindërve si dhe bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat, komunitetin, etj.

Plani i punës ka për bazë edhe elementet të cilat kanë të bëjnë me përcjelljen e trendeve të reja zhvillimore në arsim, pasurimin, furnizimin dhe shfrytëzimin permanent të teknologjisë arsimore nëpër shkolla.

Plani i punës

Plani i punës është udhëzues për organizimin e punës dhe veprimin njëvjeçar të Drejtorisë së Arsimit, duke u mbështetur në faktorët shumë dimensional, e në veçanti në faktorët kryesor që paraqesin themelin e punës në Drejtorinë e Arsimit. Po ashtu plani i punës përbëhet prej disa elementeve kryesore të cilat janë të rëndësishme në ndërtimin dhe koherencën e tij, si:

Vizioni

Misioni

Qëllimi

Vizioni

Drejtoria e Arsimit synon që arsimit në Komunën e Deçanit të zhvillohet në një ambient sa më të sigurt, modern dhe demokratik nga personeli i kualifikuar dhe i aftësuar në vazhdimësi, me përgjegjësi në punë dhe me një përfshirje cilësore të palëve të interesit. Të ofroj arsimim gjithëpërfshirës për përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme të nxënësve, iniciativën ndërmarrëse dhe pavarësinë e individit në shoqëri që të përballlet me sukses ndaj ndryshimeve të shpejta e të gjithmbarshme në mjedisin ku jetojmë.

Misioni

Drejtoria e Arsimit do të angazhohet për të siguruar arsimim sa më cilësor, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha grupmoshat e nxënësve në mënyrë që individit të shfrytëzohet tërë aftësinë e vet në përparimin (ngritjen) e cilësisë si në mësimdhënie ashtu edhe në mësimnxënie duke zbatuar teknikat, metodat dhe strategjitë më bashkëkohore të punës në këtë sferë, duke synuar që:

- Çdo nxënës pa asnjë dallim t'i sigurohen kushtet e nevojshme për nxënie cilësore të diturisë;
- Secili nxënës të shkollohet dhe arsimohet në mjedisin më të afërt, duke ju përshtatur nevojave të tyre sociale, fizike, kulturore dhe emocionale, duke shfrytëzuar të gjitha potencialet intelektuale, profesionale në mënyrë që nxënësve t'u sigurohet arsimim cilësor;
- Shkollat të afrojnë mjedis të shëndetshëm, tërheqës dhe miqësor, mësimdhënie më cilësore, në mënyrë që këto mjedise të jenë më të sigurta dhe më funksionale në misionin që kanë;
- Programet në shkollat fillore dhe të mesme në bashkëpunim me MASH-in të sigurojnë përgatitjen e nxënësve që të mendojnë dhe punojnë në mënyrë kreative dhe ambicioze në zgjidhjen e të gjitha problemeve;

- Të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme dhe shprehinë e punës për t'iu përgjigjur me sukses sfidave të jetës së përditshme, shkollimit të mëtejshëm në përvetësimin e përhershëm të mësimin me moton "Mësimi gjatë gjithë jetës";
- Shkollat të jenë të hapura, ku prindërit do të kenë mundësi të kyçjes në vendimet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët e tyre;
- Mësimdhënësit do të aftësohen në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e metodave të ndryshme bashkëkohore në procesin e mësimdhënies.

Objektivat strategjike

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Një nga prioritetet e komunës së Deçanit është përfshirja e të gjithë mësimdhënësve në trajnime cilësore që ndihmojnë mësimdhënësit që të jenë më kreativë në mësimdhënie dhe në ofrimin e përkrahjes së nevojshme për nxënës në zotërimin e kompetencave kryesore. Fokusi do të jetë në përcaktimin e qartë të rolit të DKA-së në ZHPM, në zhvillimin e mekanizmave për identifikim të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim të vazhdueshëm profesional, financim dhe monitorim të ZHPM, si dhe në përkrahjen e shkollave për ZHPM me bazë në shkollë. Objektivi dhe masat për ZHPM në komunën e Deçanit janë në harmoni edhe me masat e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë, përkatësisht me objektivin 4: Zhvillimi i mësimdhënësve dhe Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit në Deçan 2019/2022.

Objektivi Strategjik 2: Zbatimi i Kurrikulës së re

Me kurrikulën e re, roli i shkollës është sigurimi i një mjedisi mundësues për zhvillim të kompetencave. Përbushja e këtij roli të veçantë, përveç trajnimit të mësimdhënësve, lidhet edhe me ngritjen e kapaciteteve në udhëheqje të procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkollë, organizimin e punës së departamenteve/aktivave profesionale në shkolla, sigurimin e mjeteve e materialeve mësimore, si dhe përkrahjen nga DKA. Këto aspekte janë në fokus të këtij objektivi. Objektivi lidhet me OS1 për faktin se zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re varet shumë nga zhvillimi i mësimdhënësve, me OS3 sepse zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re në masë të madhe varet nga përdorimi i TIK-ut dhe mjeteve të konkretizimit në mësimdhënie dhe të nxënësve dhe me OS4 për faktin se sigurimi i cilësisë në shkollë i kontribuon zbatimit të suksesshëm i kurrikulës së re.

Objektivi Strategjik 3: TIK-u dhe mjetet e konkretizimit

Përdorimi i TIK-ut ndërlidhet me pajisjen e shkollave me kompjuterë, qasja në internet, shfrytëzimin e burimeve online, sigurimin e mbështetjes teknike dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe përgatitjen e mësimdhënësve për shfrytëzimin e TIK. Këto aspekte adresohen në masat

e vendosura për arritjen e këtij objektivi strategjik. Objektivi ndërlidhet me objektivin për zbatim të kurrikulës së re, Planin Strategjik për Arsim 2017-2021 dhe me prioritetet e komunës së Deçanit për të siguruar përdorim të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve sipas Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit në Deçan 2019/2022.

Objektivi Strategjik 4: Sigurimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë në shkollë lidhet me vendosjen e mekanizmave efektivë për sigurim të cilësisë, funksionimin e departamenteve/aktiveve profesionale, koordinimin e aktiviteteve që lidhen me cilësinë, mbështetjen nga komuna, vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe planifikimin zhvillimor, monitorimin e mësimdhënësve dhe vlerësimin e performancës së tyre. Objektivi dhe masat për sigurimin e cilësisë së arsimit në shkollat e komunës së Deçanit janë në harmoni edhe me masat e PSAK-ut 2017-2021, përkatësisht me objektivin strategjik 3: Sigurimi i cilësisë, si dhe objektivat dhe masat e Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë 2016-2020 dhe Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit në Deçan 2019/2022.

Objektivi Strategjik 5: Infrastruktura fizike

Hapësirat e mjaftueshme shkollore dhe funksionale, bëjnë që nxënësit dhe personeli arsimor të ndërveprojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Për të arritur këtë, komuna e Deçanit është përcaktuar në arritjen e këtij objektivi duke vendosur masa dhe aktivitete, që në fokus kanë përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha shkollat e komunës, sigurinë në shkollë, menaxhimin dhe mirëmbajtjen adekuate të hapësirave e objekteve shkollore, etj.

Objektivi Strategjik 6: Arsimi dhe aftësimi profesional

Ndërlidhja e arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës kërkon kohë dhe nuk mund të arrihet pa bashkëpunim me institucionet e AAP dhe bizneset. Fokusi do të jetë në funksionalizimin e Këshillit lokal për AAP, zhvillim të vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve të AAP dhe instruktorëve, zhvillim të materialeve mësimore, këshillim dhe orientim në karrierë, bashkëpunim me bizneset, pajisjen me mjete të nevojshme të punëtorëve të shkollave profesionale për të mundësuar zbatimin e kurrikulave të AAP dhe për mësimin praktik me bazë në shkollë. Masat për zhvillimin e AAP në Deçan janë në harmoni edhe me masat e PSAK-ut 2017-2021, përkatësisht me objektivin strategjik 6: Arsimi dhe Aftësimi profesional dhe arsimit të rritur.

Orientimi i përgjithshëm

Rezultatet e pritshme

- Sigurimi i hapësirës së nevojshme;
- Sigurimi i arsimit cilësor;
- Gjithpërfshirja në sistemin edukativo-arsimor;
- Arritja e rezultateve të përhershme në shkollimin parafillor, fillor dhe të mesëm në përputhje me reformat në arsim që janë duke u bërë në mënyrë permanente nga MASH;
- Bashkëpunimi dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e arsimit dhe arsimit të përgjithshëm;
- Respektimi i ligjshmërisë në sferën e arsimit;
- Profesionalizimi i mëtutjeshëm i sektorëve të DKA-së në pajtim me ligjin dhe udhëzimet administrative të MASH-it;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimit në zbatimin e kurikulës së re.
- Informimi i nevojshëm i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo arsimor në tërësi në komunën tonë.

Monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i monitorimit është që të shtohet cilësia në mësimdhënie dhe mësimnxënie, të përmirësohet plani dhe programi si dhe të shtohet efikasiteti i punës së institucioneve edukativo-arsimore në komunën e Deçanit bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit në Deçan 2019/2022.

Gjatë vitit 2021, planifikojmë të realizojmë vizita monitoruese të shpeshta në të gjitha institucionet shkollore, të jemi në kontakt të vazhdueshëm me organet drejtuese të shkollës, mësimit, nxënësit, shërbimin teknik dhe prindërit me qëllim të ofrimit të ndihmës për ngritje të efikasitetit dhe cilësisë së punës edukativo - arsimore dhe rritjes së të gjitha potencialeve për përparim të vazhdueshëm.

Pra, nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme, anketimeve, pyetësorëve, bashkëbisedimeve dhe instrumenteve tjera matëse do të realizohet mbikëqyrja për së afërmi e rrjedhës së punës në shkolla.

Në këtë drejtim për ta përmbushur këtë qëllim ne do të bashkëpunojmë edhe me Sektorin e Inspeksionit Arsimit (SIA).

Drejtoria duke u bazuar në strukturën e organizimit dhe funksionimit të DKA-se në bazë të udhëzimit administrativ të MASH, punën e vet kryesisht do ta orientojë në:

- Në krijimin dhe mbikëqyrjen e kushteve normale për punë të institucioneve edukativo-arsimore në katër nivele;
 - Niveli 0:** Arsimimi parashkollorë moshë e fëmijëve prej(1-5 vjet).
 - Niveli 1:** Arsimimi fillorë prej moshës 6 vjet.
 - Niveli 2:** Arsimimi i mesëm i ulët prej moshës 12 vjet dhe
 - Niveli 3:** Arsimimi i mesëm i lartë prej moshës 15 vjet.
- Mbikëqyrjen e realizimit të plan-programeve globale mësimore dhe atyre konkrete të mësimdhënësve në institucionet edukativo-arsimore në të tri nivelet;
- Mbikëqyrjen dhe realizimin e planprogrameve vjetore të shkollave;
- Përcjelljen dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organeve udhëheqëse dhe profesionale të shkollave;
- Përcjelljen dhe krijimin e kushteve normale për punë të nxënësve me nevoja të veçanta;
- Mbështetjen dhe krijimin e kushteve për punë shtesë të nxënësve me talent të veçantë dhe avancimin e tyre;
- Krijimin e kushteve të punës për stafin profesional të DKA-së, duke bërë aftësimin profesional të tyre përkrah zhvillimit të shoqërisë sonë dhe trendëve më bashkëkohore;
- Zyrtarët Komunal Arsimor vazhdimisht do të monitorojnë dhe kontrollojnë punën në shkolla, do të hartojnë edhe raporte për funksionimin e institucioneve arsimore me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe shtimin e përgjegjësisë në punë për të gjithë;
- Organizimi i kurseve të vazhdueshme në **Qendrën për Ngritje Profesionale (QNP)**, qendër kjo për zhvillimin profesional të mësimdhënësve me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të mësimdhënësve për punë efektive në klasë dhe për qasje bashkëkohore në trendet e reja arsimore globale.

Plani i punës së aktiviteteve në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2021

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Analiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit shkollor 2021 në fund të dy (3) gjysëmvetorëve dhe në fundin e vitit shkollor (raport në Kuvend)													Shkollat, DKA
Informatë mbi fillimin e vitit shkollor 2021													DKA
Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit të ri shkollor. Vizitë me kryetarin e Komunës në shkolla me qëllim të urimit të nxënësve dhe arsimtarëve													DKA, Kryetari, Komuna,
Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave parafillorë dhe fillorë													DKA, Shkolla
Java e gjelbërimit për shkollat e komunës													DKA, Komuna, Shkolla
Vazhdimi i bashkëpunimit me lidhjet e krijuara me Drejtorinë Komunale dhe shkolla të shteteve të ndryshme si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe arsimin e Deçanit													DKA, Shkolla, Komuna
Organizimi dhe bartja e nxënësve për garat në lëndë të ndryshme													DKA, Shkolla
Organizimi i garave në nivel komunë me nxënës të shkollave fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të larta në dramë, recitim, muzikë, art, shkenca, etj.													DKA, Shkolla
Bashkëpunimi me MASH-in-, dhe Zyrën Rajonale të Inspeksionit në fushën e arsimit													DKA
Përgatitja e projekteve për rregullim të infrastrukturës shkollore, oborreve dhe këndeve të gjelbërta të shkollave													DKA
Organizimi i garave shkollore në sport si në: futboll të vogël, basketboll, volejball dhe atletikë													DKA
Kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASH me qëllim publikimi të konkursit													DKA, MASHT

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT											Implementues	
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor		Dhjetor
Përgatitja teknike e lokaleve shkollore: gëlqerosja, dezinfektimi, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri.													Shkolla, DKA
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse: dru, thëngjill, briket, pelet, naftë.													DKA
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse: dru, naftë.													DKA
Kontrollimi i sistemit të ngrohjeve nëpër shkolla													DKA, Shkolla
Riparimi i nyjeve të ujësjellësve dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë probleme me ujë të pijshëm													DKA
Furnizimi i shkollave me mjete mësimore didaktik, kabinetet për lëndët: matematikë, fizikë, kimi, biologji,													DKA, Shkolla
Furnizimi i shkollave me inventar shkollor: banka, karrige, tavolina, tabela dhe dollapë për bibliotekat shkollore													DKA, Shkolla
Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve shkollore													DKA, Shkolla
Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive													DKA, Shkolla
Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore.													MASH, DKA
Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit	I përhershëm, sipas nevojës											DKA, Shkolla	
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave											DKA, Shkolla	
Furnizimi i shkollave me karburante për gjeneratorët	Sipas kërkesave											DKA, Shkolla	
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave	Sipas kërkesave											DKA, Shkolla	
Implementimi i pjesës që ka të bëjë me Planin Zhvillimor të DKA-së	Në vazhdimësi											DKA, Komuna	

Projektet e planifikuara gjatë vitit 2021

Nr	Projektet	Shuma
1	Ndërtimi i shkollës në Gramaqel (vazhdim i projektit 3 vjeçar)	€
2	Ndërtimi i shkollës fillore në Glllogjan (vazhdim i projektit 3 vjeçar)	€
3	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore në Irzniq (vazhdim i projektit 3 vjeçar)	€
4	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHMT "T. Kasumaj" (fillim i projektit-faza e parë)	€
5	Mirëmbajtja e objekteve shkollore	€
6	Inventarizimi i shkollave me inventar	€
7	Paisja e shkollave me kabinete profesionale	€
8	Rregullimi i tualeteve dhe pjerrinave për fëmijë me nevoja të veçanta	€
9	Renovimi i objektit të shkollës në Irzniq	€
10	Punimi i rrethojës së oborrit të shkollës në Beleg	€
11	Punimi i fushave sportive në shkollën e Gramaqelit	€
12	Izolimi i objektit të shkollës në Maznikë	€
13	Renovimi i objektit të shkollës në Prejlep	€
Gjithsej		€

Plani i punës që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Rregullimi i dokumentave për pronat e shkollave sipas sipërfaqes kadastrale	E vazhdueshme												DKA
Monitorimi i sistemit SMIA nga DKA-ja													DKA
Organizimi i mësimi shtesë për maturantët													DKA, shkolla
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbërta shkollore													DKA
Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas Prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve të Komunës së Deçanit													DKA, MASH, Etj ...
Përcjellja e braktisjes së nxënësve-detyrë permanente													DKA
Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkolla-detyrë e përhershme, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, drogës, etj													DKA
Analiza e punës edukativo-arsimor													DKA
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I përhershëm, sipas nevojës												DKA
Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas kërkesave të shkollave.	Sipas nevojës												DKA
Plotësimi i vendeve të lira të punës	Sipas nevojës												DKA
Vlerësimi i punës edukativo arsimor të shkollave nëpërmjet vizitave dhe bashkëpunimit me prindër													DKA, Shkolla
Përgatitja profesionale e mësimdhënësve, organizimi i trajnimeve në koordinim me MASH-in, etj.													DKA, Shkolla
Përgatitjet për kremtimin e festave shtetërore													DKA
Organizimi i vizitave studimore me stafin e DKA-së jashtë vendit													DKA
Përcjellja permanente e aktiviteteve mësimore e jashtëmësimore të nxënësve nëpër shkolla	E vazhdueshme												DKA, Shkolla
Shpallja e konkurseve për personelin udhëheqës - drejtor të shkollave	Sipas nevojës												DKA

Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-së me Kryetarin e Komunës, MASH-in, Drejtoritë tjera Komunale dhe Qytetarët e komunës sonë

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Takimet dhe konsultimet me Kryetarin e Kuvendit Komunal	Të përhershme, sipas nevojës												DKA
Takimet e rregullta me MASH në kuadër të takimeve me drejtorët e DKA-ve	Të përhershme, varësisht nga ftesat												DKA, MASH
Furnizimi me ligjet, udhëzimet, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASH-i	Sipas nevojës												DKA, MASH
Përcjellja e kërkesave, raporteve dhe informatave nga aktiviteti i DKA-së në MASH	Sipas nevojës												DKA, MASH
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtorëve të DKA-ve të Kosovës.													DKA
Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme													DKA
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre													DKA
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS	I përhershëm, sipas nevojës												DKA
Bashkëpunimi i rregullt me Zyrën e Inspektoratit të arsimit në nivel regional- në Pejë	Sipas nevojës												DKA
Puna me palët, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	E përditshme dhe sipas nevojës												DKA
Bashkëpunimi me Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuar	Sipas mundësive dhe nevojës												DKA

Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë: Policinë, KFOR-in, OJQ-të dhe mediat

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore organizuar nga OJQ-të etj	Sipas organizimit dhe ftesës												DKA
Bashkëpunimi me shërbimin Policor të Kosovës	Sipas nevojës												DKA
Bashkëpunimi me FSK-në	Sipas nevojës												DKA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	Sipas kërkesave												DKA
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	Sipas kërkesave												DKA
Bashkëpunimi me donatorë vendorë e të huaj	Sipas nevojës												DKA

Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe sigurisë në shkolla	Në vazhdimësi												DKA Komuna
Hartimi i programeve, planprogrameve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimdhënësve me theks të veçantë integrimi i gjinisë femërore si temë specifike	Në vazhdimësi												DKA
Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës prioritare	Në vazhdimësi												DKA
Përmirësimi i hapësirave ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punëve gjatë renovimeve	Në vazhdimësi												DKA
Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje, si dhe përcaktimi i prioriteteve të shkollave me nevoja më të theksuara.	Në vazhdimësi												DKA

Buxheti i Arsimit për vitin 2021 sipas kategorive

Buxheti sipas kategorive:

- Granti Specifik i Arsimit
- Të Hyrat Vetanake
- Granti i Përgjithshëm për Arsim

Nivelet shkollore:

- Arsimi Parashkollor
- Arsimi Fillor
- Arsimi i Mesëm i Ultë
- Arsimi i Mesëm i Lartë

Kodi i Programit	Përshkrimi	Stafi	Paga dhe Mëditje	Mallëra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunal e	Investime kapitale (rezerva)	Totali
	Arsim dhe Shkencë	xx	3 418 871.08	220 591.66	31 500.00	113 834	3 784 796.74
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		47 499.73	7 000.00	0	0	54 499.73
	Granti Specifik për Arsim		3 371 371.34	213 591.66	31 500.00	113 834	3 730 297
	Të Hyrat Vetanake		0	0	0	0	
	Huamarrja		0	0	0	0	
	Administrata e Arsimit		47 499.73	7 000.00	0	0	54 499.73
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		47 499.73	7 000.00	0	0	54 499.73
	Granti Specifik për Arsim		0	0	0	0	0
	Arsimi Parashkollor		0	0	0	0	0
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		0	0	0	0	0
	Granti Specifik për Arsim		0	0	0	0	0
	Të Hyrat Vetanake		0	0	0	0	0
	Arsimi Fillor		2 637 743.34	169 800.66	21 500.00	113 834	2 942 878.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		0	0	0	0	0
	Granti Specifik për Arsim		2 637 743.34	169 800.66	21 500.00	113 834	2 942 878.00
	Huamarrja		0	0	0	0	0
	Arsimit i Mesëm		733 628.00	43 791.00	10 000.00	0	787 419.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		0	0	0	0	0
	Granti Specifik për Arsim		733 628.00	43 791.00	10 000.00	0	787 419.00
	Të Hyrat Vetanake		0	0	0	0	0
Gjithsej			3 418 871.08	220 591.66	31 500.00	113 834	3 784 796.74

- Buxheti në total për vitin 2021 është **3 784 796.74 €** që krahasuar me vitin paraprak (**3 607 332.20**) është më i lartë **177 464.54** (ose më i ulët) për _____

Plani i Rekrutimit të Personelit Arsimor për vitin 2021

Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara rekrutimet sipas niveleve shkollore dhe llojeve të personelit të paraqitura sipas muajve për vitin 2021. Këto rekrutime janë të domosdoshme ngase janë pensionime.

Muaji	Numri i rekrutimeve	Personeli:									
		Drejtor shkolle	Z.drejtor	Sekretar	Pedagog	Mësimdhënës	Psikolog	Edukatore	Bibliotekist	Punëtor teknik	Detyrë tjetër
Janar	Sipas kërkesës	1								1	
Shkurt						2					
Mars						2					
Prill						1				1	
Maj		1				3					
Qershor						2					
Korrik										1	
Gusht						1				1	
Shtator											
Tetor											
Nëntor						1				1	
Dhjetor						1					
1	Institucioni Parashkollor (IP)										
2	Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (SHFMU)	1				10				4	
3	Shkolla e Mesme e Lartë (SHML)	1				3				1	
T o t a l i		2				13				5	

muaj	Garat në:	Sqarim për organizatorin në shkollë	Organizator:	Niveli pjesëmarrës
Janar	1.Olimpiada e Matematikës, 2.Garat e Fizikës.	1.Se cila shkollë përzgjedhë nga 1 nx. kl. IX-të, nga 2 nx. për kl. X,XI,XII. 2. Se cila shkollë përzgjedhë nga 1 nx. kl. IX-të, nga 2 nx. për kl. X,XI,XII.	1.DKA, SHMD, Aktivi i Matematikës Drejtoria e SHMP "Tafil Kasumaj". 2.DKA, Aktivi i Fizikës, Drejtoria e Gjimnazit "V. Frashëri".	1.SHMU dhe SHML 2.SHMU dhe SHML
Shkurt	1.Garat e recitatorëve për nderë të Ditës së Pavarësisë së Kosovës - 17 Shkurt 2008.	1. Se cila shkollë përzgjedhë vetëm 1 nxënës për garat në nivel komunal.	1.DKA, DKRS, aktivi i gj. Shqipe.	1. SHFMU dhe SHML
Mars	1.KANGAROO, 2.Ekspozitë me nxënës, për nder të 7 Marsit-Dita e Mësuesit, 3.Krosi me nxënës te kl. IX-të, për nderë të "24 Marsit Epopesë së Dukagjinit".	1.Nxënësit individualisht aplikojnë në sistemin online,ndihmohen nga arsimtarët e matematikës dhe tjerë. 2.Se cila shkollë përzgjedhë 5 punimet me te mira nga nxënësit e saj për ekspozitën komunale 3. Se cila shkollë përzgjedhë 2 nxënës kl IX (1 djalë dhe 1 vajzë).	1.Instituti ATOMI DKA, aktivi i Matematikës. 2.DKA,DKRS, aktivi i art. Fig. 3.DKA dhe SHPEFD.	1.SHMU 2.SHFMU 3.SHMU
Prill	1.Muzikë: Këngë dhe valle 2. Garat në Gj. Shqipe (test) 3.Volejball.	1.Se cila shkollë përzgjedhë 1 këngë dhe 1 valle për në nivelin komunal. 2.Se cila shkollë përzgjedhë nga 1 nxënës te kl. VI,VII dhe VIII-të. 3.Se cila shkollë përgatitë 1 ekip për gara në nivel komunal.	1.DKA,DKRS,Aktivi i Muzikës. 2.DKA,DKRS dhe Aktivi i gj.Shqipe 3.DKA,DKRS dhe SHPEFD.	1.SHFMU 2.SHMU 3.SHMU
Maj	1.Festivali i dramës me nxënës te shkollave fillore 2.Garat në Matematikë (Test).	1.Se cila shkollë përzgjedhë (përgatitë) 1 dramë për gara (festival) në nivel komunal. 2.Se cila shkollë përzgjedhë nga 1 nxënës nga kl. e VI,VII dhe VIII-të.	1.DKA,DKRS,Aktivi i Gj. Shqipe. 2. DKA,Aktivi i Matematikës, SHMD.	1.SHFMU 2.SHMU
Qershor	1.Garat në Fizikë	1.Se cila shkollë përzgjedhë nga 1 nxënës nga kl. e VI,VII dhe VIII-të.	1.DKA,Aktivi i Fizikës, Drejtoria e Gjimnazit "V. Frashëri".	1.SHMU
	Vërejtje: Për datat dhe orarin e saktë, shkollat do të njoftohen me kohë	Sqarim: Mirënjohjet të gjithë nxënësve fitues te nivelit komunal do të ndahen me 16 Qershor 2021-Dita e Çlirimit të Deçanit	Për organizimin e Garave, DKA me kohë ka krijuar dhe krijon Komisionet profesionale.	
Vërejtje	Këto aktivitete mund të mos zhvillohen,arsyeja COVID 19			

Vërejtje: Të gjitha këto aktivitete të parapara në planin e vitit 2021, synojmë t'i realizojmë duke u mbështetur në kapacitetet intelektuale, përgatitjet kadrovike dhe mundësit buxhetore.

Deçan, 2021

**Drejtori i Arsimit
Bekim Vishaj**